




Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.42/24
Datë: 29.04.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 29.04.2024, mori këtë;

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e 41% të aksioneve nga ndërmarrja Deutsche Lufthansa AG (blerës) mbi Italia Transporto Aereo.S.p.A., (targeti) dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë (shitësi).

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, më datë; 08.03.2024, me Nr. Prot. 146/24-11/H ka pranuar kërkesën për Njoftimi për Përqendrim lidhur me blerjen e 41% të aksioneve nga ndërmarrja Deutsche Lufthansa AG (blerës) mbi Italia Transporto Aereo.S.p.A., (targeti) dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Italisë (shitësi).

Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 28.03.2024
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 29.03.2024
3. Me datë 06 Qershor 2023 palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për blerjen e aksioneve mes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Qeverisë Italiane dhe Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft dhe Italia Transporto Aereo S.p.A.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000 Euro.
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro.
3. Marrëveshja e nënshkruar me 06.06.2023 e lidhur mes Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të Qeverisë Italiane dhe Deutsche Lufthansa Aktiengesellschaft dhe Italia Transporto Aereo S.p.A.

Deutsche Lufthansa AG (DLH), është shoqëri në kuadër të grupit Lufthansa e cila është një nga shoqëritë më të mëdha ajrore në Evropë si nga numri i pasagjereve ashtu edhe nga të ardhurat. DLH ofron shërbime të transportit ajrore të pasagjereve, transportit ajror të ngarkesave dhe shërbimeve të lidhura.

DLH operon fluturime në 320 destinacione në 104 vende, me një flote prej më shumë se 700 avionesh. Bazat kryesore të aeroporteve të DLH-së për aktivitete ndërkombëtare janë në Frankfurt, Mynih, Zyrih, Bruksel dhe Viene. Në vitin 2021 DLH mbarti afërsisht 101.8 milion pasagjere dhe realizojë një xhiro prej 32.77 miliard Euro.

Grupi Lufthanas përbëhet nga segmentet Network Airlines, Eurowings dhe Shërbimet e Aviacionit.

DLH është një nga linjat ajrore kryesore në Evropë dhe segmenti i saj i rrjetit Airlines (d.m.th. biznesi i transportit ajrorë të DLH) përfshin, ndër të tjera. Lufthansa Passenger Airlines, Swiss International Air Lines Ltd., Brusseles Airlines A.A/N.V., Austrian Airlines AG, Air Dolomiti L.A.R.E. S.p.A., Eurowing GmbH, Eurowing Discover GmbH, Edelweiss Air AG, dhe shoqërinë e saj të përbashkët me Turk Hava Yollari A.O (Turkish Airlines), Gunes Ekspres Havaciliki A.S (“SunExpress”).

Eurowings është linja ajrore e Grupi e cila ofron shërbime pikë-me-pikë me një flote aktuale prej 139 avionësh e cila fokusohet në fluturimet e shkurtra direktet brenda Evropës (me shumë se 100 destinacione në mbi 50 vende.)

ITA- është themeluar me dekretin e datës 9 tetor 2020 nga Ministria, me marrëveshjen me Ministrin e Infrastrukturës dhe Transporteve, Ministrin e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale të Qeverisë Italiane. ITA filloi të funksionojë në tetor të vitit 2021.

ITA është aktive në industrinë e transportit ajror të pasagjerëve në rrugën kombëtare dhe ndërkombëtare. Në vitin 2021, ITA mori në dorëzim një pjesë të aseteve të aviacionit të Alitalia-së të nevojshme për të menaxhuar operacionet e ITA-së.

ITA ofron transportin ajror për pasagjeret për Italinë (ku ofron fluturime nga/për Rome dhe Milano) dhe ofron fluturime direkt dhe lidhëse me kryeqytetet me të mëdha Evropiane, destinacionin Mesdhetare dhe në tregjet me rritjen më të shpejtë ndërkontinentale për turizëm tradicional dhe biznes. ITA është anëtare e aleancës ajrore globale, Sky Team, e cila përfshinë Aerolineas Argentinas, Aeromexico, Air Europa, Air France, China Airlines,

China Eastern Airlines Corporation Limited, Czech Airlines, Delta Air Lines, Garuda Indonesia, etj.

ITA pritet me dal nga Aleanca Sky Team dhe pas mbylljes së transaksionit, të lidhë me DLH-në marrëveshjen detyruese për zhvillimin strategjik dhe industrial.

ITA ka gjithashtu qarkullim të kufizuar lidhur me transportin ajror të mallrave/ngarkesave që vjen nga transporti i ngarkesave në barkun e avionëve për pasagjere dhe është anëtarë e aleancës Sky Team Cargo (e themeluar dhe e drejtuar nga Aleanca ajrore Sky Team).

Struktura e Përqendrimit

Palët pjesëmarrëse në përqendrim kanë lidhur Marrëveshje për investim ashtu që DLH nëpërmjet investimit në kapitalin e ITA-së përfiton një pjesëmarrje fillestare në masën 41% të kapitalit aksionar, me një opsion për të blerë aksione të tjera në të ardhmen, si dhe të drejta shtesë vendimmartje/vetoje sipas parashikimeve të Marrëveshjes dhe statutit të ITA-së.

Ky përfitim bëhet në kontekstin e privatizimit të ITA-së nga Qeveria Italiane sipas Dekretit të parë dhe të dytë të Presidentit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Italisë, në të cilat janë përcaktuar parimet kryesore për privatizimin e plotë të ITA-së brenda një afati shkurtër dhe kërkojmë që aksionari kryesor i shoqërisë të jete një shoqëri ajrore.

Kapitali aksionar i Shoqërisë do të zotohet si me poshtë:

- MEF do të zotërojë Aksione të Klasës B që përfaqësojnë 59% të kapitalit aksionar të Shoqërisë;
- DLH do të zotërojë Aksione të Klasës A që përfaqësojnë 41% të kapitalit aksionar të Shoqërisë.

Tregu i Produktit

DLH dhe ITA ofrojnë shërbime të transportit ajror të pasagjerëve dhe transportit ajror të mallrave:

- Transporti ajror i planifikuar i pasagjerëve, dhe
- Transporti ajror i mallrave.

Kompania në Kosovë operon vetëm në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës. Sipas të dhënave. Aeroporti i Prishtinës ka 84% të tregut të trafikut të përgjithshëm në Kosovë. Duke marr parasysh zëvendësueshmerin e aeroportit të Prishtinës, pasagjeret nga Kosova, 8% prej tyre përdorin Aeroportin e Shkupit (SKP, Maqedonia e Veriut), 5% përdorin Aeroportin e Tiranës (TIA, Shqipëri) dhe 1% udhëtojnë drejt/nga Sofja (SOF, Bullgari). Pjesa e mbetur prej 2% është e shpërndarë neper aeroporte të tjera rajonale në vendet fqinje.

Tregu gjeografik

Sipas udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, tregu gjeografik do të thotë tregu që përfshinë zonën në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në furnizimin dhe kërkesën e mallrave ose shërbimeve, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftë homogjene dhe mund të dallohen nga kushtet në zonat fqinje.

Për faktin se kemi të bëjmë me transport ajror, tregu përkatës gjeografik duhet të përcaktohet mbi bazën e pikë origjine/pike destinacioni për Kosovën. Informacioni i dhënë është i bazuar kryesisht në përfaqshjen tradicionale të përkufizimit të tregut pike nisje/pikë destinacioni duke marr në konsideratë zëvendësuesin mes aeroporteve (lidhur me zonat e shërbimeve që mbivendosen) kur është e përshtatshme. Çdo kombinim i një pike origjine dhe një pike definicioni konsiderohet si një treg i ndarë nga pikëpamja e zëvendësuesit të kërkesës.

Analiza e konkurrencës

Në bazë të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës është përmbushur kriteri ligjor për paraqitje të Njoftimit për Përqendrim. Tregu për transportin ajror të pasagjerëve dhe transportin ajror të mallrave sipas të dhënave të fundit të disponueshme për pasagjerët nga Kosova, në muajin Tetor 2022-Shtator 2023 ishte përafërsisht 2.86 milion. Pasagjeret e grupit Lufthansa për nga Kosova në dy muajt e fundit ishin 0.63 milion (me pjesëmarrje në treg 22%) me Eurowings, Edelweiss Air, dhe Austrian Airlines si transportuesit kryesor të grupit Lufthansa aktiv në Kosovë. ITA ka filluar operimet me 15 tetor 2021 dhe që atëherë nuk ka pasur pasagjer për/nga Kosova. Andaj, transaksioni i tillë nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose prishjes së konsiderueshme të konkurrencës efektive të tregut. Ndërmarrjet në transaksion nuk kryejnë shërbime direkte në tregun e Kosovës dhe palët nuk kanë mbivendosjen në tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Arsyeja e kërkesës së njoftimit për përqendrim është se pala njoftuese DLH ofron shërbime ajrore në Kosovë. Transaksioni i propozuar nuk do të ketë efekte negative në konkurrencën e tregut kosovar, pasi që palët nuk planifikojnë të shtrijnë aktivitetin e tyre në Kosovë për shkak se ITA-ja nuk ka operatorë dhe nuk ka planifikuar të ofroj shërbime nga/në Kosovë. Transaksioni i propozuar nuk do të rezultojë me ndryshime në strukturën horizontale apo vertikale të tregut.

Komisioni i Konkurrencës ka konstatuar se përqendrimi i njoftuar bie në fushëveprimin e Ligjit, pasi i plotëson kërkesat e nenit 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 nenit 15 dhe nenit 16 të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës, andaj ka vlerësuar se si i tillë, referuar nga “Njoftimi” nuk do të paraqesë efekte negative për konkurrencën, sepse nuk do të rezultojë në kufizim të konkurrencës, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese në tregun përkatës, në Republikën e Kosovës.

Shënim:


Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI**

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Florent Mehmeti
Anëtar

Salihe Gashi Loku
Anëtare

III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva